



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 429/2 Prot.

Tiranë, më 28.05.2019

V E N D I M

Nr.48, Datë 28/05/2019

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN AUTORITETI I
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) DHE
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË MBIKËQYRJES**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi I Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),

VËREJ SE:

Me Vendimin nr. 20, datë 4.4.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në

proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programine Mbikëqyrjes nr. 387/1 prot., datë 4.4.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili, me shkresën nr. 387/2 prot., datë 4.4.2018, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin AKEP”*, i është njoftuar institucionit.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në institucionin Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si institucion i pavarur, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, *“fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 429 prot., datë 19.4.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 1086/3 prot., datë 7.5.2019, *“Mbi projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në AKEP”*, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*,

miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në institucionin Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes, në kushtet kur nuk janë konstatuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil.
2. Për këtë vendim të njoftohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA